



Në bazë të Ligjit Nr. 06/L – 114 për zyrtarët publikë, Neni 34 (2 dhe 3) dhe Rregullores (QRK) NR. 16/2020 për pranimin dhe karrierën në shërbimin civil të Republikës së Kosovës, Nenet: 7 dhe 9, Komuna Shtime shpall:

Konkurs

Pranim

Aplikimi është i hapur për të gjithë kandidatët e interesuar.

Emri i grupit	Specialistë të Përgjithshëm të Shërbimeve Sociale
Institucioni	Komuna Shtime
Nr. i Referencës	RN00009097
Kodi	RPC0002846
Data e njoftimit	24.05.2022
Afati për aplikim	14.06.2022 - 21.06.2022

1. Përshkrimi i përgjithshëm i punës

- Të kujdeset për mbrojtjen e fëmijëve pa kujdes prindëror, besimi, strehimin familjar, kujdestarinë, strehiin e përkohshëm familjar.
- Të bëjë mbrojtjen e fëmijëve me sjellje asociale dhe delikumente.
- Të shqyrtojë rastet e abuzimit dhe të lënjes pas dore të fëmijëve dhe të marr masa dhe veprime të duhura.
- Të punojë në sanimin e marrëdhënieve të çrregulluara bashkëshortore e familjare
- Bënë propozimin për besimin e fëmijëve në rastet e shkurorëzimit të prindërve përcjellë realizimin e kontakteve.
- Përcjellë rastet e dhunës në familje dhe rastet e trafikimit.
- Bënë mbrojtjen e tëmoshuarve dhe jep propozime lidhur me to

2. Kërkesat e përgjithshme për pranim

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të zotërojë njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- Të jetë i aftë në pikëpamje shëndetësore për të kryer detyrën përkatëse;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një veprë penale me dashje;
- Të mos ketë në fuqi një masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik, të pushuar sipas këtij ligji.

3. Kërkesat e përgjithshme formale

- Arsimimi i kërkuar: Diplomë/a të studimeve universitare në punë sociale, psikologji, juridik, administratë publike me të paktën 180 kredi/ECTS apo ekuivalente me to.
- Kualifikime të posaçme formale
- Përvoja e punës e kërkuar: Së paku 2 (dy) vite përvojë pune në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës.

4. Kërkesat (Njohuri, Aftësi dhe Cilësi) e përgjithshme të nevojshme

- Njohuri të plotë dhe të specializuara në fushën profesionale specifike
- Nivel të lartë të njohurive profesionale ose teknike të fushës përkatëse dhe të kuptuarit e fushave që ndërlidhen me detyrat dhe përgjegjësitë
- Njohuri të mira të metodave kërkimore që ndihmojnë në përgatitjen e raporteve bazike ose analitike dhe në marrjen e vendimeve
- Aftësi të arsyetimit logjik dhe analizës
- Aftësi për të bërë gjykime profesionale të pavarura dhe për të ushtruar diskretion mbi çështjet dhe për të dhënë një kontribut të rëndësishëm në zhvillimin dhe zbatimin e politikave
- Shkathtësi hulumtuese, analitike vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale
- Aftësi komunikimi dhe ndikim personal, përfshirë aftësitë për të përfaqësuar.

5. Pozitat aktualisht të lira

Kodi	Nr. i Referencës	Titulli i pozitës	Klasa e pozitës	Koeficienti	Institucioni	Organizata / Vendi i punës
RPC0002384	RN00008595	Zyrtar për Shërbime Sociale 1	Profesional 3	6.5	Komuna Shtime	Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale / Qendra për Punë Sociale-Komuna e Shtimes

6. Mënyra e aplikimit

Përmes portalit për rekrutim elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

7. Dokumentacioni që duhet paraqitur për aplikim



- Kopjet e diplomave të dhëna nga institucionet arsimore
- Kopjet e dëshmisë së punësimit
- Kopjet e dëshmisë së trajnimeve

8. Mënyra e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve

- Testimi me shkrim
- Vlerësimi i biografisë
- Intervistë

9. Fusha e njohurive, cilësive dhe aftësive që do të vlerësohen

Aftësi që idhen me vendin e punës, logjike, të përgjithshme, njohuri lidhur me legjislacionin në fuqi

10. Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët

- Përmes email dhe portalit për rekrutim elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

11. Shpallja e rezultateve përfundimtare

- Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, fituesi do të shpallet përmes portalit për rekrutim elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>). Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike.

Të dhëna shtesë:

Komunitetet joshumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në shërbimin civil të Kosovës, siç specifikohet në Ligj. Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre, gjinia më pak e përfaqësuar dhe personat me aftësi të kufizuara inkurajohet të aplikojë për pozitat e shpallura. Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk prahen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen

